

## ACPD

### **Përmirësimi i parandalimit të HIV përmes transmetimit vertikal ( nga nëna-te fëmija)**

Sipas raportit të fundit të nxjerrë nga Organizata Botërore e Shëndetit (WHO), UNAIDS dhe UNICEF numri i grave shtatzëna me HIV që përdorin ilaçe dhe kurime për të mbrojtur fëmijët e tyre është rritur në 60% nga 2005 në 2006, por nevojitet akoma punë për tu bërë.

Raporti i Organizatës “Fëmijët dhe AIDS”, është fokusuar në 4 pika kyçe për vendet me nivel të ulët dhe të mesëm ekonomik: në përdorimin e mjekimeve antiretrovirale për parandalimin e transmetimit vertikal të HIV nga nëna te fëmija; në trajtimin e HIV te fëmijët; parandalimi i infeksioneve të reja të HIV te fëmijët dhe moshat e reja; mbrojtja dhe suporti personave në moshë të re të infektuar me HIV.

Në vitin 2006, 351.034 gra shtatzëna të infektuara me HIV që jetojnë në vendet me nivel të ulët dhe të mesëm merrnin mjekim për parandalimin e transmetimit te fëmijët e tyre, krahasuar me vitin 2005 ku këtë mjekim e merrnin vetëm 220.085 kemi një rritje prej 60%.

Ky raport gjithashtu thekson se numri i fëmijëve të infektuar me HIV që kanë përfituar nga programet mbi AIDS është rritur deri në 70% nga 2005 në 2006. megjithatë është deklaruar një rënie e prevalencës së HIV për vajzat nga moshë 15-24 vjeç.

Zbulimet e fundit kanë treguar se është bërë progres në lidhje me parandalimin e transmetimit vertikal nga nëna te fëmija, veçanërisht në Afrikën Jugore. Në fund të vitit 2006, 21 shtete morrën pjesë në takimin mbi Zhvillimin e Objektivit të shekullit mbi trajtimin e 80% të rasteve të transmetimit vertikal deri në vitin 2010.

Gjithsesi ky raport thekson faktin se egzistojnë ende gra të cilat nuk marrin trajtim mbi parandalimin për transmetimin vertikal të HIV/AIDS. Vetëm 23% e grave shtatzëna me HIV pozitiv marrin trajtim për parandalimin e transmetimit vertikal të HIV. Duhet marrë masa për forcimin e sistemit të shëndetit, reduktimin e stigmës, rritjen e informacionit tek familjet dhe komuninteti, si dhe përmirësimin e të gjithë faktorëve pengues për këtë lloj trajtimi.